

MARENGLLEN VERLI**KRYENGRITJA ANTIOSMANE E VITIT 1910
SIPAS BURIMEVE DOKUMENTARE
AUSTRO-HUNGAREZE***

Revolucioni xhonturk i 3 korrikut 1908 hapi “kutinë e Pandorës” në Perandorinë Osmane. Aspak unikë për rrugën që duhej ndjekur për shëndoshjen e “të sëmurit të Bosforit”, turqit e rinj, në shumicën e tyre, vlerësuan politikën e centralizimit, të dorës së fortë dhe të ideologjisë panosmane, si shtegun nga duhej kaluar për të shmangur shkatërrimin. Por ishte pikërisht ky shteg që çoi në kolaps e pas 4 vjetësh në shembjen e Perandorisë. Të lejohej Kushtetuta, të krijohet parlament, të lejohej arsimimi në parim në gjuhën amtare, të tolerohej pluralizmi politik e mediatik dhe, nga ana tjetër, të luftohej për panosmanizmin, për vendosjen e “rregullit” të rreptë edhe aty ku qeveria nuk ofronte asnjë përmirësim konkret të kushteve të jetës, të ndërhyhej me çdo mënyrë për të penguar aspiratat nacionale, deri edhe në çështje të alfabetit, duke përdorur shpesh e me më pak takt se më parë dhunën ekstreme, të bëje pra bashkë të gjitha këto, ishte po aq e pamundur sa edhe të njësoje pole të kundërt.

Natyrisht, përballë regjimit qeverisës kontradiktor xhonturk, edhe shqiptarët nuk ishin të njësuar. Përveç atyre që iu kundërvunë autoriteteve xhonturke nga pozita kombëtare demokratike, kishte edhe kategori që vlerësonin më të mirë regjimin e vjetër të sulltan Hamitit, ose që, me një patriotizëm krahinor, përpiqeshin të ruanin trajtimin preferencial apo venomet e dikurshme të një krahine të caktuar dhe, natyrisht, nuk mungonin edhe të tjerë që kishin interesa thjesht personale e familjare, ose që, për arsye të ndryshme ishin në konflikt me shtetin si shkelës të legjislacionit të tij, si debitorë ekonomikë të tij, si përfaqësues të lobeve dhe agjenturave të huaja etj.¹

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë: “Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë”, më 30 prill 2010, organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë.

¹ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Fondi Arkivi i Vjenës, Vj. 20.10.1100. Sipas një raporti të konsullit Para nga Selaniku dt. 21 maj 1910, për ambasadorin e A-H në Stamboll, Pallaviçinin, në Shkup para shpërthimit të kryengritjes ishin mbledhur Haxhi Rustem Kabashi i Prizrenit, Sulejman Batusha i Gjakovës, Shaban

Gjithsesi periudha nga korriku i vitit 1908 deri në pranverën e vitit 1910 karakterizohet nga hapa të dukshëm pozitivë të shqiptarëve në përgjithësi për realizimin e aspiratave kombëtare. Kushtetuta e 23-24 korrikut 1908 lejoi hapjen legale të shumë klubeve dhe shkollave shqipe anekënd trevave shqiptare, madje mbajtjen e kongreseve për mbarëvajtjen e tyre dhe njesimin e alfabetit, gjithashtu siguroi përfaqësimin e shqiptarëve në parlament dhe, paralelisht, gjallërimin e publicistikës mediatike, shtimin e botimeve didaktike në gjuhën shqipe etj. dhe, së fundi, hartimin e programeve kombëtare më cilësore.

Të gjitha ngjarjet, që pasuan vendosjen e “Hyrjetit”, duke përfshirë tronditjet politike në Perandori në pranverën e vitit 1909, me epiqendër në Stamboll dhe kryengritjet në vise të ndryshme të Perandorisë, pa përfshirë edhe trevat shqiptare, kanë gjetur një pasqyrim të detajuar në dokumentacionin e kohës, ku një vend të rëndësishëm zë dokumentacioni konsullor austro-hungarez. Me interesa të veçanta në rajon, Austro-Hungaria, e pozicionuar në këtë kohë për ruajtjen e status-kuosë, i kushtonte vëmendje të veçantë dhe vëzhgonte me kujdes zhvillimet në trevat shqiptare. Ky interes, profesionalizmi i personelit konsullor dhe shpeshësia e raportimeve të detajuara, na sigurojnë kështu një informacion të vyer.

Kryengritja e pranverës së vitit 1909 në Malësinë e Gjakovës, e Podrimës dhe Malësisë së Prizrenit në verë, si edhe e Dibrës në vjeshtën e po atij viti dhe ekspeditat ushtarake të Xhavit Pashës për shtypjen e tyre, kongreset e Dibrës më 23-29 korrik 1909, të Elbasanit më 2-8 shtator, hapja e shkollës së famshme, Normales pedagogjike të Elbasanit më 1 dhjetor, veprimtaria e atdhetarëve të shquar si Ismail Qemali, Dervish Hima, Ibrahim Temo, Orhan Pojani, Luigj Gurakuqi, Dom Nikollë Kaçorri etj., themelimi i gazetave “Dielli” (në Boston), “Shqypeja e Shqypënis” (në Sofie), “Zgjimi i Kombit” (në Janinë), “Lidhja Ortodokse” (në Korçë), “Bashkimi i Kombit” (në Manastir), “Bashkimi” (në Shkodër), mandej hartimi i promemorieve e thirrjeve të ndryshme, themelime shoqërishe e komitetesh, të gjitha këto ngjarje e

Kopriva e Isa Boletini të Mitrovicës, Hasan Hyseni i Budakovës, Hasan Feri i Plavë-Gucisë. Konsulli theksonte se këta kishin vendosur të bashkëpunonin me elemente si Ramadan Zaskohu (që në krye të 8000 burrave ndodhej në Tetovë) për të ruajtur privilegjet e vjetra. Konsulli përmend edhe Nasim Beun, Nexhip Dragën dhe pejanin Bejtulla Efendiun, që i kishin borxh qeverisë 600 piastra.

fakte, gjejnë pasqyrim masiv dhe interesant në raportet konsullore apo korrespondencën e diplomatëve austro-hungarezë të kohës².

Aty gjejnë pasqyrim edhe ato ngjarje të tjera të vitit 1910, që lidhen me ofensivën e xhonturqve për t'i imponuar shqiptarëve, deri edhe me mitingje, alfabetin arab (në Shkup, Manastir, Elbasan, Gjakovë, Korçë, Gjilan, Vuçiternë, Mitrovicë), gjithashtu reagimi i shqiptarëve me kundërmitingje për alfabetin latin (në Elbasan, Korçë, Berat) etj.³

Në situatën e ndezur të vitit 1909 dhe të pranverës së vitit 1910, dokumentacioni diplomatik austro-hungarez me burime nga konsullatat ose përfaqësitë e Ballplatzit në Mitrovicë, Prizren, Shkup, Manastir, Shkodër, Durrës etj., por edhe Janinë, Selanik etj., gjithashtu nga ambasadat në Stamboll, Romë e Berlin dhe nga Ministria e Jashtme në Vjenë, i dërguar përkatësisht nga konsujt Tahy, Prohaska, Adamkieviç, Bornemisza, Halla, Zambaur, Bilinski, Para, ambasadori Pallaviçini, ministri Erental etj., na informojnë në mënyrë mjaft të detajuar si për shkaqet ashtu edhe për kohën e vendin e fillimit të kryengritjes antiosmane të 100 vjetëve më parë. Ky dokumentacion na ofron edhe mjaft të dhëna të tjera, deri imtësitë që lidhen me luftimet, lëvizjet e trupave, drejtuesit në të dy kampet, bashkëbisedimet, kontradiktat etj. etj. Raportet konsullore bëjnë të ditur se shkaku kryesor për shpërthimin e kryengritjes së vitit 1910, ishin pakënaqësitë në rritje në shtresa të ndryshme të popullsisë ndaj qeverisjes xhonturke, veçanërisht lidhur me rritjen e madhe të tatimeve, me këmbënguljen për mbledhjen e tyre, me masat për çarmatimin e popullsisë, me kërkesën për rekrutë etj. Rritja e tatimeve deri në dhjetë herë u ndje veçanërisht në viset ku për shkak të trajtimit të mëparshëm, të diferencuar preferencial, tatimet kishin qenë të vogla (Himara nga 5300 piastra duhej të paguante 4800 piastra)⁴, armët ishin lënë të lira dhe rekrutë nuk ishin mbledhur. Politika e re xhonturke sipas konsujve preku shumë vise të Kosovës, Dibrën, Himarën. etj. Xhonturqit, duke e vlerësuar trevën e Shkodrës zonë strategjike, i diferencuan shkodranët nga të tjerët, por ata ishin të rreptë për të kërkuar zbatimin e ligjeve të reja në Kosovë, Dibër e Himarë. Madje u kërkuan rekrutë edhe nga popullsia e besimit katolik, deri atëherë e pa përfshirë në rekrutimin e rregullt. Natyrisht ndër kryengritësit, sikurse u përmend edhe

² AIH, Fondi Arkivi i Vjenës, dosje të vitit 1909.

³ Po aty, Vj. 20-10.1028 deri 20-9.987, dosje të vitit 1910, periudha mars-maj.

⁴ Po aty, Vj. 20.10.1049, Njoftim i konsullit Kraus nga Vlora, dt. 15.V.1910.

më sipër, kishte edhe nga ata që motivoheshin për të kapur armët nga arsye të tjera që lidheshin me pakënaqësi të trashëguara, me rivalitete të krerëve e deri me motive ordinere. Në acarimin e situatës diplomatët e huaj në Shkup mendonin, sikurse rehatonte konsulli i A-H, Adamkieviç, se kishte ndikuar edhe qëndrimi i patakt i valiut të Kosovës, Masar Beut⁵.

Në këtë situatë në fund të marsit 1910 në viset e Mitrovicës, Vushtrisë dhe Llapit dhe në Rrafshin e Dukagjinit, sipas konsujve të Mitrovicës dhe Prizrenit, filluan veprimet e para të armatosura kryengritëse. Më 5 prill kryengritësit sulmuan garnizonin osman në Babin Most dhe pastaj u regjistruan një varg përpjekjesh e hapash të tjerë, përfshi edhe një mbledhje tradicionale për lidhje bese e kundërshtim të qeverisë të Verrat e Llukës (në Rrafshin e Dukagjinit)⁶.

Kryengritësit vunë nën presion pas kësaj forcat osmane në shumë vise të Kosovës. Sipas njoftimeve që i shkonin Vjenës nga personeli konsullor, i akredituar në “vilajetet shqiptare”, më 21 prill kryengritësit u rezistuan forcave osmane në Shtimje, në 23 prill 10.000 kryengritës sulmuan 8 batalione osmane pranë Carralevës, kurse më 24 prill, nën drejtimin e Idriz Seferit, sulmuan trupat që shkonin në Ferizaj, kapën Grykën e Kaçanikut dhe bllokuan ose vunë nën kontroll vijën hekurudhore Shkup-Mitrovicë, duke kontrolluar, ndaluar ose lejuar kalimin e trenave atje. Një ditë më pas trupat osmane ishin tërhequr nga Shtimja, Carnaleva, Kaçaniku, kurse 3000 kryengritës ishin përqendruar në Junik. Më 26 prill konsulli i Mitrovicës njoftonte se kryengritësit do t’u jepnin betejë turqve të Gryka e Kaçanikut dhe një ditë më pas telegrafonte sërish për të informuar se garnizoni i Mitrovicës ishte nisur drejt Kaçanikut dhe se autoritetet e atyshme, në panik se qyteti i lënë pa mbrojtje të mjaftueshme mund të sulmohej, po armatosnin gjithë nëpunësit e shtetit, shkruesit, infermieret, bandën muzikore ushtarake etj. Më 28 prill Mitrovica ishte përforcuar edhe me 2 kompani nga Novipazari⁷.

⁵ *Po aty*. Vj. 20-5-526. Shih njoftimin e Adamkieviçit nga Shkupi të dt. 2.V.1910 për MPJ. Sipas tij konsujt e huaj në Shkup, veçanërisht konsujt e Anglisë, Italisë dhe Francës kishin bindje se qëndrimi i Masar Beut ishte acarues ndaj ai duhej të largohej patjetër nga posti i valiut të Kosovës.

⁶ *Po aty*, Vj.20-8-811; 20-8-812; 20-8-818; 20-9-969, etj. Njoftime të konsujve nga Prizreni, Mitrovica etj., të prillit 1910.

⁷ *Po aty*, Vj. 20-8-820, Telegram nga Mitrovica i Tahyt dt. 23.IV.1910 për MPJ; Vj. 20-8-821, Telegram nga Mitrovica dt. 23.IV.1910, Tahy për MPJ; Vj. 20-8-823, Telegram dt. 25.IV.1910 nga Mitrovica etj.; Vj. 20-9-972. Prohaska nga Prizreni

Ndërkohë konsuj të tjerë raportnin se kryengritësit në Kaçanik ishin përforcuar nga luftëtarë lumjanë e dibranë kurse një grupim tjetër kryengritës mbante në tension Gjakovën⁸. Informacioni për Vjenën shtohet për datat 30 prill – 1 maj kur gjenerali osman Shefqet Turgut Pasha, i dislokuar në Shkup që në mes të prillit, filloi ofensivën për të çarë pritën te Gryka e Kaçanikut⁹.

Shpesh specialistët ushtarakë kanë diskutuar përse kryengritësit i dhanë betejë forcave osmane në fund të Grykës së Kaçanikut, afër vendit të quajtur “Guri i shpum”, pas së cilës fillon rrafshi i Kosovës, ku ushtria është e vështirë të ndalet. Dokumentacioni austro-hungarez sjell të dhëna që arsyetojnë këtë zgjedhje të kryengritësve të imponuar nga rrethanat, kur forcat e kryengritësve ishin relativisht të pakta dhe kur forcat osmane të dislokuara në Kosovë ndërmorën një inkursion nga veriu në drejtim të Grykës së Kaçanikut (3 reparte të divizionit nga Ferizaj dhe forca të tjera iu drejtuan lartësive të Kaçanikut). Në këtë rast pozicioni te Guri i Shpum ishte i vetmi që u jepte mundësi kryengritësve për të shmangur rrethimin dhe për t’u tërhequr pa dëme drejt pozicioneve të reja.¹⁰

Përveç informacioneve që lidhen me lëvizjet e trupave, veprimet dhe përleshjet ushtarake, pas Grykës së Kaçanikut në disa pika të tjera në rajonin e Gjilanit, gjithnjë nën drejtimin e Idriz Seferit, heroit të betejës së Kaçanikut, mandej qëndresës në grykat e Shtimjes e Caralevës nën drejtimin e Isa Boletinit, Hasan Hysenit të Budakovës etj., në raportet e konsujve gjejmë informacion edhe për numrin e të vrarëve, për spastrimin e teatrit të luftimeve, për tradhëtira e pasivtete, për premtime e mosangazhime, si në rastin e kapedanit të Mirditës etj., për mosmarrëveshje në kampin politik e ushtarak xhonturk në Stamboll dhe në terrenin e veprimeve ushtarake, për mobilizim serioz trupash, për hyrjen në veprim të ushtarakëve të shquar të Perandorisë si gjenerali Shefqet Turgut Pasha, apo të vetë ministrit Mahmut Shefqet Pashës, etj.¹¹ Nuk mungojnë informacione edhe për pikëpamje atdhetarësh në vilajetet

telegram MPJ më 25.IV.1910; Vj. 20-8-825, Tahy nga Mitrovica për MPJ më 27.IV.1910.

⁸ *Po aty*, Vj. 20-10-1075. Njoftim telegrafik i konsullit Para nga Selaniku për ambasadorin në Stamboll.

⁹ *Po aty*, Telegrame të dt. 30 prill -1 maj 1910.

¹⁰ *Po aty*, Dokumentacion i prillit dhe majit 1910. Shih posaçërisht në: Vj. 20.5.524, telegramin e Adamkieviçit nga Shkupi për MPJ, dt. 29.IV.1910.

¹¹ *Po aty*.

e Manastirit dhe të Janinës, që e konsideronin të papërshtatshëm momentin e kryengritjes, që vlerësonin se vëmendja duhej përqendruar në zgjidhjen e çështjeve të arsimit, kulturës dhe përgjithësisht të emancipimit dhe përgatitjes së popullit për përqafimin e programit kombëtar, etj.¹²

Posaçërisht trajtohet ato ditë qëndrimi i Ismail Qemalit, që sipas ambasadorit të A-H, Pallaviçinit, kish kritikuar qeverinë xhonturke për dhunën brutale ndaj shqiptarëve të ushtruar që në vitin 1909, me anën e Xhavit Pashës, mandej për shpenzimet e 60% të buxhetit shtetëror për ushtrinë dhe abandonimin e ekonomisë, si edhe ishte prononcuar se dyshonte për arritjen e një marrëveshjeje austrohungarezo-italiane që kërcënonte ndarjen e Shqipërisë¹³. Disa ditë më pas Pallaviçini i raportonte Vjenës se personaliteti shqiptar i kish deklaruar se Turqia ndodhej në rrezik të madh jo vetëm nga shqiptarët por edhe nga nënshtetasit e saj në Maqedoni, Mesopotami, Arabi, pa përmendur rreziqet në kufijtë shtetërorë, sepse regjimi xhonturk kish gabuar rëndë duke hartuar një program shovinist turk¹⁴.

Përfaqësuesit diplomatikë austro-hungarezë bënë edhe analizën e qëndrimit të fuqive të tjera ballkanike ndaj ngjarjeve brenda Perandorisë Osmane, veçanërisht të Serbisë dhe Bullgarisë që tregoheshin të gatshme të ndihmonin Turqinë kundër shqiptarëve “nëse [ajo] ndeshte vështirësi të mëdha”, e posaçërisht Ruisë, nxitjen e së cilës ndaj Stambollit për ta shtypur me egërsi kryengritjen e vlerësonin si politikë të Peterburgut për të konsumuar energjitë e Perandorisë dhe për ta armiqësuar atë me shqiptarët, natyrisht edhe për të dërmuar forcën e këtyre në këtë konflikt të brendshëm¹⁵. Në këtë konkluzion, raportonin diplomatët austro-hungarezë, kishin arritur edhe një pjesë e elitës drejtuese xhonturke, çka kishte sjellë përçarje në Stamboll lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj shqiptarëve. Vjenës nuk i kishte shpëtuar pa vënë re edhe skepticizmi britanik, i shprehur përmes deklaratave të ministrit të Jashtëm Eduard Greit, lidhur me seriozitetin e kryengritjes shqiptare,

¹² *Po aty*. Dokumentacion i marsit 1910.

¹³ *Po aty*. Vj. 20-14-1471. Raport i Pallaviçinit për MP Jashtme në Vjenë, dt. 23 prill 1910.

¹⁴ *Po aty*, Vj. 20-14-1478. Relacion i Pallaviçinit dt. 27.IV.1910 për MP të Jashtme.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 20-13-1319; Vj. 20-14-1473; etj. Raporte e telegrame të dt. 25.IV.1910.

edhe agresiviteti i shtypit të Stambollit ndaj A-H, të cilën e akuzonte se kishte dorë në ngatërresat që po ndodhnin në Shqipëri, edhe prononcimet e qëllimshme italiane në të njëjtën kahje, ndonëse këto insinuata nuk kishin asgjë të vërtetë. Alergjikë ndaj Vjenës që pas humbjes së Bosnjës xhonturqit, përmes Rifat Pashës, i kishin bërë me dije ambasadorit të A-H, në Stamboll Pallaviçinit se i kishin marrë gjithë masat për shtypjen e kryengritjes dhe se, sido që të ishte, në rast të një lufte të jashtme shqiptarët do t'i bashkoheshin armatës osmane¹⁶.

Vihet re qartë në kuadrin e gjithë këtyre informacioneve, analizave e vlerësimeve, se për Vjenën nuk kishte dilema rreth rritjes së peshës së faktorit shqiptar në Ballkan dhe vëmendjes së veçantë që i duhej kushtuar atij. Madje rreth kësaj çështjeje ministri i jashtëm a-h, konti Erental, i jepte instruksionet e duhura më 21 prill 1910, ambasadorit të vet në Stamboll, Pallaviçinit. Ridimensionimi i faktorit shqiptar në sytë e diplomacisë vjeneze shkonte deri aty sa ministri i nënvizonte ambasadorit se “kriza politike në Shqipërinë Veriore është e tillë që do të çojë ose në nënshtrimin e shqiptarëve ose në *dështimin ushtarak definitiv të Turqisë*”, por nëse krijohej vakum në rastin e një largimi të mundshëm të turqve nga rajoni, aty nuk duhej lejuar ekspansioni serb, sepse planet pansllaviste ishin të drejtuara jo vetëm kundër Turqisë, por edhe kundër Austro-Hungarisë¹⁷.

Në kuadër të vëmendjes gjithnjë më të madhe të Vjenës për shqiptarët dhe lëvizjen e tyre kombëtare, në raportet konsullore shtohen edhe të dhënat që lidhen jo vetëm me veprimtarinë dhe personalitetin e figurave si I. Qemali, D. Hima, I.Temo, etj., por edhe informacionet që kanë të bëjnë me krerët e kryengritësve në terren. Gjatë prillit dhe majit të vitit 1910 mbizotërojnë të dhënat që kanë të bëjnë me drejtuesin e Betejës së Kaçanikut, Idriz Seferin. Sipas raporteve konsullore, I. Seferi me 400 kryengritës edhe pas largimit nga Gryka e Kaçanikut vijonte t'i bënte qëndresë të fortë trupave të Xhavit Pashës në luginën e Morovës. Konsulli Para njoftonte në dt. 2 maj nga Selaniku se, një korrespondent

¹⁶ *Po aty*, Dokumentacion i prillit 1910; Vj. 20-14-1481. Raport i Pallaviçinit për Vjenën, dt. 28.IV. 1910.

¹⁷ *Po aty*, Vj. 20-14-1470. Erental për Pallaviçinin, dt. 21.IV.1910; Vj. 20-10-1074. Erental për Pallaviçinin, dt. 28.IV.1910.

austro-hungarez në Shkup, kish servitur lajmin se I. Seferi ishte në shërbim të Vjenës, se deri para 6 muajsh kish qenë katolik, se ishte një individ dinak etj.¹⁸

Forca e kryengritjes, që vijoi e fuqishme edhe pas tërheqjes së kryengritësve nga gryka e Kaçanikut, humbjet e mëdha të ushtrisë, por edhe të shqiptarëve për shkak të terrorit e dhunës së egër të ushtruar mbi ta, i detyruan autoritetet ushtarake osmane të ndalonin hyrjen e korrespondentëve të huaj në zonat e luftimeve. Konsujt njoftonin se në të njëjtën ditë, më 5 maj, ndërsa në parlament, në Stamboll u diskutua çështja shqiptare, në Ferizaj e Gjilan u shpall shtetrrëthimi. Një ditë më pas ministri i luftës i Perandorisë, Mahmut Shefqet Pasha u nis për në Selanik e Shkup në një mision të paqartë për Pallaviçinin, që një herë, më 6 maj, raportonte se sipas kryeredaktorit të gazetës “Tanin”, ministri do të shkonte për bisedime me krerët e kryengritjes kurse në një njoftim të datës 7 maj pohonte se udhëtimi kishte destinacion Selanikun dhe lidhej me grindjet e shfaqura ndër ushtarakët e dërguar për shtypjen e kryengritjes shqiptare. Ndërkohë drejt Kosovës niseshin forca të mëdha ushtarake¹⁹.

Është me interes të theksohet se në komunikimet me diplomatët e saj, gjatë gjysmës së parë të majit, Vjena rikonfirmon qëndrimin e saj se duhej qëndruar në pozicion vëzhgues ndaj kryengritjes dhe kërkonte informacion për qëndrimin e popullsisë shqiptare të besimit katolik. Konsullit Zambaur nga Shkodra njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme më 7 maj se katolikët e Shkodrës po rrinin të qetë. Dy ditë më vonë ai rehatonte se një farë Hysen Beu nga Gjakova po propagandonte kundër kryengritjes duke theksuar se nga acarimi me qeverinë kosovarët nuk do të fitonin asgjë. Konsulli informonte më tej katolikët e Murturit, Nikajt dhe Shalës donin të bashkoheshin me katolikët e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, kurse Preng Pasha (Preng Bib Doda – M.V.) propagandonte bashkimin e Mirditës me kryengritësit²⁰.

Raportet dhe telegramet e datave 9-11 maj të dërguara nga konsujt dhe ambasadori për MP të Jashtme, në Vjenë janë të mbushura me

¹⁸ *Po aty*, Vj. 20-7-796. Njoftim i konsullit Para nga Selaniku për MPJ, dt. 2.V.1910.

¹⁹ *Po aty*, Vj. 20-14-1487; Vj. 20-14-1489. Njoftime të Pallaviçinit për Vjenën, dt. 6 dhe 7 maj.

²⁰ *Po aty*, Vj. 20-4-442; Vj. 20-14-1454. Telegramet të MPJ për Pallaviçinin dhe Zambauerin në Stamboll e Shkodër, dt. 7.V.1910, si edhe përgjigjet e Zambauerit, VGj. 20-3-387; Vj. 20-3-388, dt. 7 dhe 9.V.1910.

njoftime për masivitetin e kryengritjes (15.000 me kosovarë, lumjanë e dibranë), për dy ditët e luftimeve të ashpra të kryengritësve në rrugën Ferizaj-Prizren, për veprime ushtarake e diplomatike të krerëve si Isa Boletini në Rrafshin e Dukagjinit dhe Idriz Seferi, Sabri Kaja e Adem Kabashi në Luginën e Moravës, etj. Këta të fundit, sipas raportimeve, me ndërmjetësinë e priftërinjve të Letnicës dhe Ferizajt po përpiqeshin të hynin në bisedime me qeverinë për të ndaluar masakrimin e popullsisë civile²¹.

Në informacionet e dt. 10 maj flitet për pushtimin e Gjakovës nga 8000 kryengritës, për propozimin aty nga Bajram Daklini për të marshuar në Kosovë, për trazira në sanxhaqet e Dibrës dhe Elbasanit (zona e Çermenikës), pjesë të Vilajetit të Manastirit, për qëndrim të vendosur antiqeveritar në zonën e Krujës (vilajeti i Shkodrës), për gatishmërinë e prijësve të malësorëve të Plavë-Gucisë e Krasniqes (Hasan Feri në Plavë-Guci, Jashar Pasha e Zenel Beu në Pejë, Shaban Binaku në Krasniqe) për t'i kthyer krahët Turqisë në favor të Austro-Hungarisë etj. Konsulli nga Manastiri saktësonte se ishte folur për pjesëmarrjen e 1000-2000 dibranëve në kryengritjen e Kosovës, por shifra reale duhej të ishte 200²².

Në dokumentacionin diplomatik austrohungarez nuk mungon informacioni edhe për deklaratat e Ministrisë të Luftës Mahmut Shefqet Pashës, se trupat në Kosovë ishin përforcuar me 16 batalione që marshimi drejt Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës të bëhej me 30 batalione (rreth 10.000 ushtarë – MV.) për të thyer “mijëra arnautët”, që kishin bllokuar rrugën Ferizaj-Prizren, mandej për punën e kallauzit Rustem Kabashi, i cili në krye të 4 batalioneve i nxori ushtarët në shpinë të kryengritësve duke i dhënë fund qëndresës së fortë të 7-9 majit në malësinë e Cërnalevës²³. Në datën 11 maj konsulli Para nga Selaniku njoftonte ambasadorin Pallaviçini se në luftimet pranë Velistrinës dhe Debrenicës, kishin marrë pjesë 12.000 kryengritës nën udhëheqjen e I. Boletinit.

Ndërkohë dokumentacioni konfirmon në vazhdimësi se Ismail Qemali ishte politikani kryesor shqiptar në fokusin e vëmendjes së Vjenës. Sipas korrespondencës midis MP të Jashtme në Vjenë dhe ambasadorit Pallaviçini në Stamboll, theksohet se “*udhëheqësit shqiptar*” (term i MPJ) i ishte argumentuar se nuk ekzistonte ndonjë pakt a-h-italian

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, Vj. 20-10-1084; Vj. 20-5-537; Vj. 20-7-799; Vj. 20-8-833; Vj. 20-13-1324; Informacione nga raporte e telegrame të dt. 9-10 maj nga konsujt e Shkupit, Selanikut, Mitrovicës, Manastirit etj.

²³ *Po aty*.

që të synonte copëtimin e Shqipërisë dhe i ishte dhënë garanci se A-H ishte e interesuar për “zhvillimin dhe bashkimin e popullit shqiptar”. Kurse ndër qeveritarët osmanë Austro-Hungaria, përmes ambasadorit Pallaviçini, përpiquej të ndikonte te Rifat Pashai, duke i paraqitur pikëpamjen e Vjenës se acarimi i gjendjes në Shqipëri sillte rreziqe për Perandorinë Osmane²⁴.

Informacionet nga korrespondenca e datave 12-20 maj tregojnë se, edhe pse e thyer në frontet kryesore, edhe pse shumë krerë ishin kapur e arrestuar dhe midis krerëve gjithnjë më të dukshme po konstatoheshin shenjat e përçarjes (Shaban Binaku e Sulejman Batusha të Gjakovës me 1500 hasjanë e kishin lënë vetëm në Caralevë Isa Boletinin, Haxhi Rustem Kabashi udhëhoqi ushtrinë për t’i dalë në shpinë kryengritësve në Caralevë, etj.) kryengritja ende nuk ishte shtypur dhe batalioneve të ekspeditës xhonturke u duhej të depërtonin me luftë në viset e ndryshme të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, deri në zonat e thella si Kalisi i Lumës, në malësitë e Pejës dhe Gjakovës, në Plavë e Guci etj., duke pësuar vazhdimisht humbje. Sipas konsullit Adamkieviç të Shkupit humbjet më të mëdha kishin qenë ato të luftimeve të 7-9 majit në Caralevë, ku ushtria kishte patur 21 oficerë të vrarë e 18 të plagosur si edhe 393 ushtarë të vrarë, 278 të plagosur dhe rreth 100 të humbur²⁵. Por nga informacioni i datave të sipërpërmendura, del gjithashtu se xhonturqit, duke u prirur të dëgjonin këshillat e këqija, i kishin hyrë rrugës së rrezikshme për t’i thyer, çarmatosur, shtruar me çdo kusht shqiptarët. Në këtë kuadër mund të përmendet njoftimi i konsullit Kraus nga Vlora për MP Jashtme në dt. 15 maj, se 7 fshatrat e Himarës ishin rrethuar nga toka e nga deti (2 batalione dhe 2 torpendinierë)²⁶. Interesant ishte edhe njoftimi i konsullit Para nga Selaniku i dt. 17 maj për Pallaviçinin, se batalionet e urdhëruara të ndiqnin I. Boletinin ishin të përbëra nga ushtarë “arnautë”²⁷. Ndërkohë njoftime të dt. 17-20 maj sjellin informacionin se gradualisht në viset e Mitrovicës, Gjakovës,

²⁴ *Po aty*, Vj. 20-14-1493; Vj.20-14-1494; Vj. 20-10-1086; Korespondencë midis MPJ dhe ambasadorit në Stamboll, Pallaviçinit, dt. 10.V.1910.

²⁵ *Po aty*, Vj. 20-5-541; Vj. 20-10-1091; Informacion i Adamkieviçit nga Shkupi, dt. 12 dhe 14 maj 1910 për MPJ në Vjenë.

²⁶ *Po aty*, Vj. 20-10-1049; Relacion i Kraus nga Vlora për MPJ në Vjenë, dt. 15.V.1910.

²⁷ *Po aty*, Vj. 20-10-1095; Telegram i Paras nga Selaniku për Pallaviçinin dt. 17.V.1910.

Pejës, Prizrenit dhe Gjilanit po vendosej qetësia, se shumë kryengritës të kapur po çoheshin në gjyqin ushtarak të ngritur në Ferizaj (sipas konsullit Para 33 lumjanë, 12 burra nga zona e Gjilanit etj.) se në trevën dhe qytetin e Ferizajt kishte filluar çarmatimi; kurse popullsisë së Mitrovicës, Vuçiternit dhe Prishtinës i ishte dhënë afat deri në mesditën e 20 majit që të dorëzonte armët²⁸. Sipas një njoftimi telegrafik nga Prizreni të konsullit Prohaska, të 24 majit, çarmatimi kishte filluar edhe në krahinën e Ostrozubit.

Për të shuar sa më shpejt kryengritjen, përveç përdorimit të terrorit ushtarak, politikës së diferencuar ndaj krerëve e viseve të ndryshme shqiptare, premtimeve, kërcënimeve etj., qeveria xhonturke me sa duket shfrytëzoi edhe propagandimin apo ngacmimin e temës së konflikteve me fqinjët. Konsulli Zambaur nga Shkodra njoftonte MPJ, më 21 maj, se nën shtytjen e Esat Pashës dhe Riza Beut, aty ishte propaganduar çështja e Kretës dhe ishte nxitur jo pa sukses popullsia të jepte vullnetarë kundër Greqisë. Ndërkohë, sipas konsullit të Selanikut, Para, në Dibër do të organizohej një miting për të njëjtën gjë, në të cilin pritej të kërkohet nga malësorët rekrutimi në ushtrinë turke që do të marshonte në Thesali. Konsulli i vilajetit të Manastirit, njoftonte ndërkohë se, me sa dukej, propagandisti më i rëndësishëm i xhonturqve për çështjen në fjalë ishte Njazi Beu, me nismën e të cilit ai kishte dëgjuar të thuhej se do të formohej një grup prej 1000 vullnetarësh. Mitingje të ngjashme për çështjen e Kretës sipas konsullit Bilinski ishin organizuar në Janinë e Prevezë dhe qe tentuar pa sukses për të bërë të njëjtën gjë edhe në Gjirokastër. Konsulli theksonte se, këtu qëndrimi i qeverisë për çështjen e alfabetit dhe masakrimi i shqiptarëve të Kosovës, kishin “shkaktuar një zemërim të thellë te popullsia”. Në kuadër të problemit të Kretës me sa duket duhet parë edhe veprimi i Preng Pashës, për të mbledhur bajraktarët e Mirditës, që sipas konsullit të Shkodrës, bëhej për të mbajtur qetësinë pro qeverisë në atë krahinë²⁹.

Jo vetëm shpërthimi dhe zhvillimi i kryengritjes, por edhe shtypja e saj i aktivizuan diplomacitë evropiane për të ruajtur status-kuonë në rajon. Duke parë largimin masiv të kryengritësve nga Kosova drejt Malit të Zi dhe, me

²⁸ *Po aty*, Vj. 20-8-836; Vj. 20-8-838; Njoftime telegrafike të Tahyt nga Mitrovica për MP Jashtme, dt. 17-20 maj 1910.

²⁹ *Po aty*, Vj. 20-3-390; Vj. 20-7-743; Raport i konsullit Zambaur nga Shkodra për MP Jashtme, dt. 21 maj 1910; Vj. 20-11-1101; Raport i konsullit Para nga Selaniku për Pallaviçinin në Stamboll, dt. 24 maj 1910; Vj. 20-6-615, Njoftim i Bitinskit nga Janina për MP Jashtme, dt. 29 maj 1910.

sa duket, veprimet e Knjaz Nikollës për të përfituar nga situata, përfaqësuesit e Ruisë, Italisë dhe Francës e këshilluan Malin e Zi të sillej korrekt e paqësisht. Sipas ministrit Erental në një njoftim-telegram të 25 majit për ambasadorin Pallaviçini, kjo bëhej sepse një aksion i Malit të Zi në Shqipëri do ta nxiste A-H të shkelte përsëri Novi Pazarin dhe këtë gjë nuk e dëshironte veçanërisht Italia³⁰. Gati në të njëjtën kohë Adamkieviçi, konsulli në Shkup, në një raport për Vjenën, rekomandonte se nëse A-H mendonte të ndërhynte në përkrahje të nacionalistëve shqiptarë, për zgjidhjen e çështjes shqiptare, duhej të bashkonte krerët shqiptarë, të furnizonte popullsinë me ushqime e municione, si edhe t'i merrte shqiptarët nën mbrojtje. Me sa duket në këtë mënyrë konsulli mendonte se bëhej e mundur të dështonte taktika e Shefqet Turgut Pashës, përkatësisht e qeverisë, për të zhvilluar bisedime për të bërë premtime e për të arritur marrëveshje veçmas me krerët e ndryshëm shqiptarë³¹.

Hulumtimi i dokumentacionit diplomatik austro-hungarez për muajt mars-maj 1910, me ndriçimin shumëdimensional rreth situatës së brendshme e ndërkombëtare në viset shqiptare dhe posaçërisht informacioni rreth kryengritjes së Kosovës të vitit 1910, sjell pa dyshim të dhëna interesante për një moment shumë të rëndësishëm historik në rrugën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që lejojnë arritjen e konkluzioneve thelbësore, ndër të cilët më i rëndësishmi është se shqiptarët, pavarësisht nga diferencat, pengesat, shpejtësia e veprimit etj., po shkonin në rrugën e duhur drejt të ardhmes, pësia e tyre po rritej dhe po ashtu interesi për ta te disa fuqi të mëdha, ndër të cilat pa dyshim në pozicionin më favorizues shfaqej Perandoria Austro-Hungareze.

³⁰ *Po aty*, Vj. 20-15-1507. Telegram i MP Jashtme, dt. 25 maj 1910 për Pallaviçinin në Stamboll.

³¹ *Po aty*, Vj. 20-5-546, Raporti i Adamkieviçit për MPJ, dt. 23.V.1910.